

Manuali i RAN për programet e trajnimit mbi parandalimin/ luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm/PVE

Udhëzime për trajnuesit dhe politikëbërësit

Përmbledhje

Ekspertët e trajnuar mirë janë të domosdoshëm për çdo përpjekje në parandalimin dhe luftën kundër ekstremizmit. Për rrjedhojë, tema e trajnimit ka zënë një vend të rëndësishëm në axhendat e shumë mbledhjeve të Rrjetit për Ndërgjegjësimin kundër Radikalizmit (RAN) gjatë vitit 2017. Kjo arriti pikën kulmore në aktivitetin me temë *»Trajnimi i ekspertëve për parandalimin dhe luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm«* të zhvilluar në Bruksel më 16 nëntor. Ky manual praktik mbi programet e trajnimit për parandalimin/luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm (CVE/PVE) është frymëzuar nga njohuritë dhe ekspertizat e shkëmbyera gjatë këtyre aktiviteteve, si dhe në përgjithësi në kuadër të rrjetit RAN. Manuali i botuar nga RAN jep udhëzime dhe këshilla praktike për trajnuesit dhe politikëbërësit.

Ky manual është hartuar nga Qendra e Ekselencës e RAN. Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument u përkasin autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Komisionit Evropian, RAN-it apo ndonjë institucioni tjetër.

Hyrje

Trajnimi i profesionistëve ka qenë gjithmonë një pjesë mjaft e rëndësishme e qasjeve ndaj parandalimit të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Profesionistët janë të domosdoshëm për parandalimin/luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm, por ata duhet të jenë të përgatitur për të luajtur një rol mjaft të rëndësishëm. Nën hijen e kërcënimit në rritje të ekstremizmit të dhunshëm nëpër Evropë, shumë qeveri (vendore) kanë vendosur të rrisin investimet e tyre në edukimin dhe trajnimin e politikëbërësve dhe ekspertëve. Por, teksa shumë prej tyre janë tashmë duke u trajnuar, lind nevoja të dimë se në cilën shkallë këto programe janë duke arritur ndikimin e synuar. Ndërkohë që shumë prej tyre janë duke u vlerësuar (pjesërisht), pjesa më e madhe nuk janë duke iu nënshtruar këtij vlerësimi. Bazuar në përvojën e trajnuesve lidhur me çfarë funksionon dhe çfarë jo, mund të jetë e mundur të përcaktohen praktika efektive. Por rezultatet nuk janë gjithnjë të qarta dhe nuk vlejné për çdo trajnim.

Shtetet anëtare dëshirojnë të sigurohen se programet e trajnimit do të arrijnë rezultatet e synuara. Gjithashtu, shtetet anëtare ndodhen përballë sfidës për të vlerësuar (më mirë) dhe për të garantuar ndikimin e programeve të ofruara të trajnimit.

Për hartimin e kurseve të trajnimit, mund të bëhet një ndërthurje e elementëve nga programe të ndryshme, dhe këta elementë mund të përkthehen në seanca të personalizuar trajnimi. Nuk është nevoja që çdo gjë të fillojë nga zero. Trajnimi duhet të ketë objektiva të qarta, pasi koha dhe burimet janë të kufizuara, dhe parandalimi/lufta kundër ekstremizmit të dhunshëm mbulon një gamë të gjerë fushash. Për të hartuar programe trajnimi me objektiva të qarta, duhet të përcaktohet qartë që në fillim se çfarë duhet të mësojnë njerëzit nëpërmjet trajnimit: çfarë njohurish nevojiten për kryerjen e punës apo detyrës në fjalë? Cilat janë njohuritë ekzistuese të profesionistëve? Cilat janë njohuritë ekzistuese të cilat mund të zhvillohen? Cilat janë aftësitë ekzistuese? Për më tepër, ndikimi i një programi trajnimi varet nga mënyra sesi ai ofrohet. Atëherë, cila është mënyra më efektive për ofrimin e trajnimit?

Ky Manual i RAN shërben për të udhëhequr programet e trajnimit të profesionistëve mbi parandalimin/luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm, si në nivelin strategjik ashtu edhe në atë praktik. Struktura e manualit është si vijon:

1. Ofrimi i programeve të trajnimit;
2. Udhëzime praktike për trajnuesit;
3. Udhëzime praktike për vënien në praktikë të trajnimit.

1. Ofrimi i programeve të trajnimit

RAN ka përcaktuar disa elementë të cilët kanë gjasa të kontribuojnë në efektivitetin e trajnimit. Nga njëra anë, përmbajtja duhet të jetë e balancuar, trajnimi duhet të vendoset në kontekst, dhe trajnuesi duhet të jetë i besueshëm. Gjithashtu, trajnimi duhet të jetë sa më praktik. Mund të jetë me dobi ofrimi i trajnimit për një grup të përzier, me qëllim për të fuqizuar bashkëpunimin ndërinstucional që nevojitet për përballjen me fenomenin e radikalizmit, si një fenomen me shumë shkaqe dhe dimensione. Nga ana tjetër, të mësuarit përmendësh të disa sinjaleve nuk funksionon. Thjesht »zgjedhja e kutizave« në një listë me zgjedhje mund të çojë në akuza të pajustificuara apo në sinjalizime të pavërteta. Gjithashtu, teoria duhet të lidhet me praktikën: nga njëra anë, ju duhet ta lidhni teorinë me praktikën, dhe nga ana tjetër duhet të arsyetoni veprimet tuaja.

Në përgjithësi, ofrimi i programeve të trajnimit në mënyrë interaktive ka rezultuar i dobishëm, duke rritur përfshirjen dhe duke ofruar një përvojë më angazhuese. Për ofrimin e programeve të trajnimit në mënyrë interaktive¹, janë të domosdoshëm elementët në vijim:

- Krijimi i një raporti me audiencën: njihuni me personat e pranishëm. Krijoni një marrëdhënie me ta. Gjeni trajnues dhe përmbajtje të përshtatshme, dhe shkëmbeni përvojat tuaja si trajnues për të krijuar një lidhje me audiencën tuaj.
- Qëndrueshmëria: fuqizoni të trajnuarit. Përdorni trajnimin në formë pyetjesh, kërkimin e opinioneve, analizën e burimeve, dhe praktikoni zhvillimin e bisedave të vështira në mënyrë që të fuqizohen të trajnuarit.
- Vetëbesimi: zhvilloni vazhdimisht aktivitete reflektimi dhe të menduari, si dhe jepni lavdërime.

Ofrimi i programeve të trajnimit mbi parandalimin/luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm

Seksionet e mësipërme vlejné për ofrimin e programeve të trajnimit në përgjithësi. Megjithatë, ofrimi i trajnimit mbi parandalimin/luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm ndryshon nga ofrimi i trajnimit mbi përdorimin e një baze të re të dhënash në punë. Duhet të merren në konsideratë disa elementë dhe ndjeshmëri specifike, të cilat janë përshkruar në vijim:

1. Kompleksiteti. Procesi i radikalizmit influencohet nga shumë faktorë dhe mund të shprehet në shumë mënyra. Për rrjedhojë, programet e trajnimit nuk mund »thjesht« të japin një listë të »sinjaleve të qarta për konstatimin e radikalizmit«, së bashku me disa informacione historike, dhe të pretendojnë më pas që profesionistët të jenë të përgatitur për të trajtuar çështjen. Profesionistët duhet të jenë të aftë të kuptojnë kompleksitetin dhe pasigurinë që karakterizon radikalizmin.
2. Ndjeshmëria. Radikalizmi është një temë e ndjeshme për një sërë arsyesh. Ekspertët mund t'i tremben kësaj teme apo mund të fyhen nga keqpërdorimi i fesë/ideologjisë së tyre. Këto ndjeshmëri pasqyrohen në diskutimet që janë pjesë e pashmangshme e programeve të trajnimit

¹ Elementët e prezantuar nga Carys Evans (Connect Futures) në aktivitetin tematik të RAN të zhvilluar në Bruksel më 16 nëntor, në prezantimin me temë: Trajnimet interaktive - Disa vrojtime

mbi radikalizmin. Disa të trajnuar mund të kenë kundërshtimet e tyre ndaj përkufizimeve dhe terminologjisë së përdorur. Disa të tjerë do të pyesin veten nëse duhet të përfshihen në këtë çështje (apo jo). I takon trajnuesit të gjejë balancën e duhur dhe t'i kushtojë vëmendjen e duhur kësaj çështjeje. Megjithatë, ajo nuk duhet të kthehet në një debat të pafund. Ekspertët mund ta kenë të vështirë të gjejnë rolin e tyre, pasi mund të kenë frikë të »spiunojnë« apo të denoncojnë njerëz. Ata mund të kenë pyetje lidhur me faktin nëse mund t'i ndajnë shqetësimet e tyre, kur mund t'i ndajnë ato dhe cilat do të jenë pasojat e këtij veprimi.

3. Paragjykimet personale. Është e pamundur të mbash një qëndrim të paanshëm. Megjithatë, është e mundur të ruash profesionalizmin: dallo preferencat e tua personale, mëso sesi të mos i shfaqësh ato publikisht, dhe mos bjer në kurthin e frikës.

Ofrimi i programeve të trajnimit në një kuadër ndërinstitucional

Bashkëpunimi ndërinstitucional kontribuon në parandalimin e radikalizmit, dhe për rrjedhojë, programet e trajnimit janë një mundësi e shkëlqyer për të hedhur bazat për këtë bashkëpunim. Megjithatë, prania e profesionistëve nga fusha të ndryshme në trajnim ka ndërlidhjet e saj. Trajnuesi mund të ndihet i sfiduar përballë perspektivave të ndryshme, paragjykimeve (të mundshme) dhe mund të mungojë besimi mes profesionistëve..

Rekomandimet për programet e trajnimit në një kuadër ndërinstitucional:

- Fokusohuni te të përbashkëtat mes profesionistëve dhe jo te dallimet mes tyre: gjeni objektivin e përbashkët dhe mbajeni parasysh atë. Fokusohuni gjithashtu te gjetja e një gjuhe të përbashkët.
- Ekspertët duhet të njihen me njëri-tjetrin, me përgjegjësitë e tyre, si dhe me gjuhët dhe aftësitë profesionale të njëri-tjetrit. Trajnimi ndërinstitucional duhet të fillojë nga këtu.
- Përfshini çdo perspektivë, pasi secila prej tyre duhet të trajtohet në mënyrë që të gjithë të shohin tablonë e përgjithshme.
- Trajnojini grupet ndërinstitucionale disa herë (p.sh. çdo gjashtë muaj) dhe jo vetëm një herë. Vendosija e tyre në të njëjtin ambient ndihmon në fuqizimin e rrjetit duke përforcuar cilësinë e marrëdhënieve ndërmjet agjencive, individëve dhe komuniteteve — kur individët u rikthehen punëve të tyre, ata mund të mos e gjejnë kohën apo mundësinë për të punuar mbi këtë aspekt. Përsëritja e trajnimit u ofron gjithashtu pjesëmarrësve mundësinë për të përfituar njëri-tjetrin mbi zhvillimet e reja rreth fushës apo komunitetit. Ndikimi i trajnimit mund të matet duke reflektuar mbi atë çfarë profesionistët kanë mësuar dhe mbi shkallën e përvetësimit të njohurive apo aftësive.
- Mësoni nga njëri-tjetri duke shkëmbyer përvoja dhe raste. Kjo do t'i ndihmojë profesionistët të tregohen më mendje-hapur ndaj homologëve me background të ndryshëm. Për më tepër, profesionistëve u pëlqen të shkëmbejnë përvoja nga puna e tyre, dhe përmes kësaj ata mund të gjejnë zgjidhje për problemet me të cilat përballen.

2. Udhëzime praktike për trajnuesit

Ky kapitull jep udhëzime praktike për trajnuesit e programeve mbi parandalimin dhe luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm. Sfidat për trajnuesit, si dhe këshillat dhe marifetet për përballimin e këtyre sfidave, janë përshkruar në tabelën në vijim.

Sfida	Këshilla dhe marifete
Do të donit që pjesëmarrësit të ishin më të angazhuar në trajnim. Çfarë duhet të bëni?	<ul style="list-style-type: none"> • Proveni metodat e mëposhtme: <ul style="list-style-type: none"> ○ Punoni në grupe të vogla dhe në çifte. Njerëzit janë zakonisht më të hapur ndaj shkëmbimit kur punojnë në grupe të vogla. ○ Krijoni një mjedis të favorshëm për një përfshirje sa më të madhe, duke përdorur lojëra për »thyerjen e akullit«, jini sa më të hapur si trajnues, dhe njihuni me audiencën. ○ Vendosni rregulla bazë në mënyrë që të jetë e qartë sesi zhvillohet trajnimi për të gjithë, përcaktoni qartë se çfarë është e (pa) pranueshme. ○ Lejojini njerëzit të shkruajnë nëpër letra me ngjytje »post-it« nevojat, frikën dhe pritshmëritë e tyre, dhe t'i ngjisin ato në mure. ○ Jepini trajnimit karakter më personal. Shkëmbeni përvojat tuaja. ○ Vazhdoni komunikimin rreth strukturës së programit. ○ Lejojini të trajnuarit të krijojnë diagrama. Ushtrimet e hartëzimit shërbejnë edhe për të identifikuar njohuritë ekzistuese dhe ato të munguara të të trajnuarve. ○ Çmitizoni fenomenin e ekstremizmit, por pa e zvogëluar ndikimin e mundshëm më shumë seç duhet. Puna mbi parandalimin e radikalizmit përfshin në një masë të madhe përdorimin e aftësive dhe ekspertizës suaj.
Si mund të siguroheni se trajnimi është një përvojë për pjesëmarrësit, dhe jo një leksion?	<ul style="list-style-type: none"> • Jepni informacion paraprak mbi parandalimin e radikalizmit. Më pas fokusohuni mbi aftësitë dhe reflektimin gjatë trajnimit. • Përdorni situata simuluese në formën e lojërave me role.
Ju duhet të krijoni një program të ri trajnimi në vendin tuaj. Si mund ta nisni një trajnim nga e para? Çfarë duhet të bëni dhe çfarë jo?	<ul style="list-style-type: none"> • Bëni një vlerësim të mirë të nevojave: cilat gjëra përbëjnë nevoja dhe cilat janë më pak të nevojshme? • Bazohuni në programe të ngjashme të vlerësuara apo premtuese, të projektuara për qëllime të ngjashme, apo në elementë/pjesë të tyre. • Vendosni objektiva pozitive që shihen pozitivisht nga grupi i synuar. • Përfshini partnerë profesionistë për t'i kthyer ata në bashkëpunëtorë. Nëse grupi i synuar dhe/ose të dashurit e tyre mund të bëhen partnerë, akoma më mirë. • Jini realistë: çfarë mund të arrini në rast se burimet tuaja janë të kufizuara? Cilët janë personat që kanë vërtetë nevojë për trajnim? Çfarë mund të pritët prej tyre?


<p>Jeni të pasigurt nëse profesionistët duhet të trajnohen në grupe të përziera apo në grupe të veçanta. Cila është zgjidhja më e mirë?</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Kjo varet nga objektivi i trajnimit tuaj: <ul style="list-style-type: none"> ○ Dëshironi të përforconi bashkëpunimin ndërinstytucional dhe besimin ndërmjet partnerëve? Në këtë rast, zgjedhja më e mirë mund të jetë trajnimi në një kuadër ndërinstytucional. ○ Dëshironi që profesionistët të kuptojnë rolin e tyre në parandalimin e radikalizmit? Atëherë rekomandohet trajnimi në grup me persona të cilët kanë të njëjtin background profesional.
<p>Shefi juaj ju kërkon të përfshini teknologji të reja në programin e trajnimit. Cilat janë opsionet tuaja? Cila është zgjidhja?</p>	<p>Opsionet janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Lojërat kompjuterike (serioze). • Të mësuarit elektronik, për shembull për transferimin e njohurive. Të mësuarit elektronik mund të përdoret gjithashtu edhe përpara trajnimit, në mënyrë që të trajnuarit të kenë një nivel bazë njohurish përpara fillimit të trajnimit. Të mësuarit elektronik është me kosto efektive, fleksibël dhe i aksesueshëm.

3. Udhëzime praktike për vënien në praktikë të trajnimit

Ky kapitull jep udhëzime praktike mbi vënien në praktikë të trajnimit. Janë përcaktuar sfidat për profesionistët dhe politikëbërësit në nivel zbatues dhe strategjik, dhe janë ofruar këshilla praktike për përballjen me këto sfida.

Niveli zbatues	
Sfida	Zgjidhja
Si mund të përzgjedhësh trajnuesin e duhur/të kualifikuar?	<ul style="list-style-type: none"> • Profili i përgjithshëm i një trajnuesi »të mirë« është si vijon:² <ul style="list-style-type: none"> ○ Karizmatik, i ndjeshëm dhe me aftësi të mira analitike. Dikush të cilin e dëgjoni me kënaqësi. ○ Një ekspert me përvojë i cili flet gjuhën e pjesëmarrësve në trajnim. Personi duhet të jetë sa më pranë fushës në fjalë. ○ I aftë për t'u përballur me çështje të ndërlikuara?
Si mund të siguroni cilësinë e ofrimit të programeve të trajnimit mbi parandalimin/luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm?	<ul style="list-style-type: none"> • Zgjidhni një trajnues i cili është trajnuar mbi temën. • Punoni me trajnues të cilët kanë aftësi të mjaftueshme pedagogjike. • Kontrolloni materialin e trajnimit me ndihmën e ekspertëve përpara trajnimit. • Kërkoni në mënyrë jozyrtare feedback-un e të trajnuarve dhe trajnuesve. • Bëni një vlerësim të shkurtër në fund të trajnimit, i cili të përfshijë disa pyetje. • Referojuni në mënyrë zyrtare një shoqërie të jashtme për vlerësimin e trajnimit dhe trajnuesve tuaj.
Si mund t'i mbani trajnuesit tuaj të përditësuar?	<ul style="list-style-type: none"> • Përdorni metodën e mbikëqyrjes: krijoni një grup ndihme që mblidhet në intervale të rregullta. • Informoni trajnuesit mbi praktikën që kanë rezultuar të suksesshme në trajnimet e mëparshme, fokusohuni në shembuj praktikë • Nxirrni mësim edhe nga përvojat e këqija: çfarë duhet të shmangni në të ardhmen? • Krijoni një platformë të përbashkët për të shkëmbyer materiale si module, video, pamje rrëshqitëse • Diskutoni mbi gjendjen e radikalizmit/ekstremizmit të dhunshëm, terrorizmin, ndikimin e tij në shoqëri dhe mënyrat e reagimit. • Merrni pjesë rregullisht në kurse të tjera mbi temën e radikalizmit. • Shkëmbeni praktika dhe theksoni metodat që janë të lehta për t'u përshtatur.

² Dy pikat e para të këtij profili janë prezantuar nga Cristina Ivan (Instituti Kombëtar për Studime Inteligjente në Rumani) në aktivitetin tematik të RAN të organizuar në Bruksel më 16 nëntor. Prezantimi i saj titullohej «Trajno trajnuesin: Çfarë u duhet pjesëmarrësve për t'u bërë trajnues? Si mund t'i mbani trajnuesit tuaj të përditësuar?»

Niveli strategjik	
Sfida	Zgjidhja
Si mund të përfshihen objektivat politike në programet e trajnimit?	<ul style="list-style-type: none"> • Përkthejini politikat në rezultate/objektiva të arritshme. • Mendoni rreth aftësive profesionale dhe njohurive të nevojshme për përmbushjen e këtyre objektivave.
Si mund ta parashikoni ndikimin që do të ketë trajnimi? Si mund të kryeni vlerësime/rishikime mes kolegëve?	<ul style="list-style-type: none"> • Në rast se jeni duke punuar mbi parandalimin, është e vështirë të kryhen vlerësime. Cila është faza e radhës? Si mund të bëhet sa më e qëndrueshme? • Përfshini metoda vlerësimi në kurs. • Mblidhni dhe ruani statistika për vlerësim të brendshëm dhe kërkim akademik. • Rishikimi mes kolegëve mund të jetë i dobishëm në rast se rishikuesit kanë një grup të mirëpërcaktuar rregullash lidhur me objektin dhe mënyrën e rishikimit. • Duke qenë se një pjesë e madhe e punës kryhet në një kuadër ndërinstitucional, duhet të përfshini të gjithë partnerët. • Kryeni vlerësime në nivelin e përdoruesit fundor/pjesëmarrësit: »Çfarë fituat nga programi i trajnimit«, si dhe në nivelin organizativ: »A ju ndihmuan programet e trajnimit të përmbushnit objektivat tuaja?« • Pavarësisht se të gjitha situatat do të jenë të ndryshme nga njëra-tjetra, përdorimi i materialeve të trajnimeve të suksesshme të zhvilluara diku tjetër — apo të trajnimeve të mëparshme mbi një temë të ngjashme — rrit shanset për sukses. Përmbajtja do të duhet të përshtatet për çdo sfidë individuale të trajtuar gjatë trajnimit.
Si mund të sigurosh përfshirjen e të gjithë ekspertëve përkatës?	<p>Përcaktoni cilët janë profesionistët që duhet të trajnohen, dhe në çfarë niveli duhet të trajnohen:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Trajnim bazë për të gjithë ekspertët 2. Trajnim i avancuar për disa ekspertë 3. Trajnim i thelluar për një numër të vogël ekspertësh  <p>Përgjithësisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mundësoni aksesin e personave në trajnim. Lini kohë për trajnimin; mos lejoni që financimi të përbëjë pengesë. • Përfshini ekspertë me përvojë dhe persona përgjegjës për kuadrin ndërinstitucional në vendimmarrjen mbi personat që duhet të trajnohen. • Bëni një dallim të qartë mes pjesëve të detyrueshme të programit të trajnimit, dhe pjesëve që mund të ndiqen në mënyrë vullnetare.

<p>Si mund të përfshihen programet e trajnimit në strategjitë kombëtare?</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Lidhni aktivitetet me objektivat e strategjisë kombëtare. • Garantoni financim të mjaftueshëm. • Sigurohuni që personat përgjegjës për strategjinë të jenë gjithashtu përgjegjës edhe për programin. • Vendosni mekanizma cilësorë për llojin dhe cilësinë e trajnimit. • Lidhni ligje dhe procedura me trajnimin. Për shembull, cilat veprime konsiderohen si përgatitje për një sulm? Cilët janë kufijtë ligjorë, dhe cilat procedura duhet të ndiqen? • Përditësoni njerëzit në rast se strategjia ndryshon.
<p>Si mund të siguroheni se njohuritë dhe aftësitë e fituara do t'i mbijetojnë kohës?</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Sigurohuni që njerëzit të dinë t'i zbatojnë në praktikë njohuritë e marra gjatë trajnimit. • Përfshini trajnimin mbi parandalimin/luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm në trajnimin e përgjithshëm dhe në programet personale të zhvillimit të profesionistëve — këto janë shpeshherë të detyrueshme për akreditim. • Mbani një regjistër me emrat e personave të trajnuar. • Planifikoni aktivitete vijuese për rifreskim njohurish, trajnioni persona të rinj me funksione të rëndësishme, dhe mbajini profesionistët të përditësuar. • Kërkojini organizatave të raportojnë mbi përpjekjet e tyre për trajnim. • Siguroni financim të mjaftueshëm për të arritur një numër të konsiderueshëm individësh të trajnuar. • Konsideroni zbatimin e mekanizmave »trajno trajnerin« për të garantuar shpërndarje të qëndrueshme.

4. Lexim i mëtejshëm

RAN ka nxjerrë një sërë publikimesh mbi temën e programeve të trajnimit, konkretisht:

Koleksioni i RAN

Kjo përmbledhje praktikash frymëzuese përfshin një kapitull mbi programet e trajnimit.

Manuali i RAN: *Reagimet ndaj luftëtarëve të huaj terroristë të kthyer dhe familjeve të tyre*

Nevojat e trajnimit për profesionistët janë përcaktuar në nivel bazik dhe në nivel të thelluar në manualin e RAN »[Reagimet ndaj luftëtarëve të huaj terroristë të kthyer dhe familjeve të tyre](#)«. Për trajnimin e personave që punojnë me të miturit e rikthyer theksohen jepen rekomandimet në vijim:

1. Siguroni trajnim të mjaftueshëm për ekspertët që punojnë me të miturit e rikthyer. Këto module mund të jenë pjesë e trajnimeve ekzistuese për ekspertizën apo rritjen e ndërgjegjësimit ndaj parandalimit dhe luftës kundër radikalizmit. Ka të paktën dy nivele të disponueshme trajnimi:
 - a) Trajnim ndërgjegjësues bazë për profesionistët në kontakt (të drejtpërdrejtë) me të miturit e rikthyer (p.sh. mësuesit e shkollave, punonjësit socialë, anëtarët e organizatave të aktiviteteve të kohës së lirë). Trajnimi bazik kërkohet të mbulojë minimalisht:
 - i) informacione mbi situatën në Siri/Irak, ndaj të cilës janë ekspozuar këta të mitur;
 - ii) ndërgjegjësim bazë mbi traumat dhe ushtrime reaguese për rastet kur një i mitur i rikthyer shfaq sjellje të caktuara;
 - iii) informacione që tregojnë sesi mund të raportohen shenjat shqetësuese dhe ku mund të kërkohet mbështetje e mëtejshme.
 - b) Trajnim i thelluar dhe seanca të të mësuarit në grup për profesionistët e përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në rastet e të miturve të rikthyer (p.sh. shërbimet e mbrojtjes së të miturve, profesionistët e ndihmës familjare, oficerët e policisë lokale, psikologët). Ky trajnim i thelluar mund të përfshijë leksione mbi përkujdesin social dhe riintegrimin në shkolla.

RAN EDU EDU (Grupi i Punës për Arsimin): [Udhëzues mbi programet e trajnimit: Mësues dhe personel akademik i besuar dhe efektiv](#)

Pjesëmarrësit e RAN EDU kanë kontribuar në hartimin e një udhëzuesi mbi programet e trajnimit për sektorin arsimor. Udhëzuesi paraqet një kuadër për diskutimin mbi alternativat e ndryshme të programeve të trajnimit dhe përcakton tre lloje programesh trajnimi për sektorin: A) Programe që ofrojnë trajnim bazë për mësues të fuqizuar dhe të qëndrueshëm. B) Programe që ndihmojnë dhe kontribuojnë në ngritjen e shkollave të sigurta dhe demokratike. C) Programe që ndihmojnë stafin të zhvillojë aftësitë e nevojshme për përballjen me sfidat aktuale.

RAN POL (Grupi i Punës për Policinë dhe Zbatimin e Ligjit): [Udhëzuesi mbi programet e trajnimit për oficerët e policisë në Evropë](#)

Pjesëmarrësit e RAN POL kanë hartuar një udhëzues që mbulon kompetencat bazë për të cilat nevojitet trajnim, programet ekzistuese të trajnimit dhe rekomandime për oficerët e policisë. Një prej rekomandimeve kishte të bënte me faktin se trajnimi duhet të përshtatet me rolin e profesionistit dhe me kontributin e tij në kuadrin ndërinstitucional në të cilin pritet të punojë. Për shembull, oficerët e policisë duhet jo vetëm të sinjalizojnë, por edhe të shkëmbejnë informacione, të përcaktojnë mënyrën e reagimit dhe ta vënë atë në zbatim.

Programet e trajnimit

Një gamë e gjerë programesh dhe metodash trajnimi u prezantuan në aktivitetin e RAN me temë *»Trajnimi i profesionistëve për parandalimin dhe luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm«*. Ato janë përmbledhur në kutitë në vijim.

Trajnimi LIVE i – OSCE

Programi i trajnimit *»Liderët kundër Intolerancës dhe Ekstremizmit të Dhunshëm«* (LIVE) synon të nxisë reagimin lokal, të sigurt dhe të shumëllojshëm ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit terrorist. Pjesëmarrësit identifikojnë nevojën për një nismë të caktuar dhe më pas fillojnë planifikimin e saj, duke u trajnuar ndërkohë. OSCE zhvillon programe trajnimi në partneritet me RAN, Connect Futures dhe organizata të tjera, për: liderët e rinj (zhvilluar dhe pilotuar në vitin 2017), lideret gra (2018) dhe liderët fetarë dhe tradicionalë (grupi mbetet për t'u përcaktuar më qartë, 2018/2019). Pjesëmarrësit e zgjedhur kanë akses të drejtpërdrejtë dhe ndikim mbi komunitetet, janë thellësisht të përkushtuar ndaj çështjeve të të drejtave të njeriut, janë të motivuar për të vepruar dhe mundësisht kanë përvoja të mëparshme në mobilizimin e komuniteteve apo në ofrimin e shërbimeve. Përbërësit kryesorë të trajnimit përfshijnë: transmetimin e një këndvështrimi të ndryshëm ndaj radikalizmit, ilustrimin e roleve të mundshme të shoqërisë civile nëpërmjet rasteve studimore (përpyetje të suksesshme dhe të pasuksesshme) dhe zhvillimin e aftësive. Metodatat e përdorura bazohen te parimi i të mësuarit përmes të vepruarit, ndërveprimit, njohjes së ekspertizës dhe potencialit të pjesëmarrësve dhe nxitjes së diversitetit dhe krijimit të besimit. Mësimet e nxjerra nga programi pilot për liderët e rinj përfshijnë faktin se pilotimi është mjaft i vlefshëm, dhe se përshtatja e përmbajtjes dhe mjeteve të vlerësimit të kursit duhet të jetë e kufizuar, me qëllim për të mos i mbingarkuar trajnuesit dhe të trajnuarit.

Trajnimi i forcave policore dhe personelit të burgjeve nga Training aid and Derad – prezantuar nga Sergio Bianchi (Agenfor)

Ky program trajnimi gjithëpërfshirës ka nëntë module. Çdo modul ka objektivat e tij të përgjithshëm dhe specifike, dhe ka një numër të madh materialesh të disponueshme, të tilla si video dhe ushtrime në lidhje me temën. Materiali i trajnimit është i disponueshëm në shumë gjuhë të ndryshme dhe mund të jetë me rëndësi për personelin e burgjeve, gjyqtarët dhe OJQ-të, ndër të tjerë.

Fokusi te radikalizimi në arsim, trajnim dhe kërkim në Shërbimin Korrektues Norvegjez – prezantuar nga Dr David Hansen (Kolegji Universitar i Shërbimit Norvegjez të Provës/KRUS)

KRUS ofron kërkime, arsimim/trajnim dhe njohuri, si dhe trajnim, këshillim dhe udhëheqje mbi bazën e kërkesës. Ai ofron kurse të ndryshme trajnimi mbi radikalizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm, në nivele të ndryshme:

- Trajnim bazë për stafin në shërbim, mbi tema të tilla si radikalizmi në burgje, situata në Norvegji, përkufizimet dhe termat, dhe format e ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit. Ky kurs zgjat 8-10 orë.
- Trajnim bazë/i avancuar për oficerët e shërbimit të provës, si pjesë e programit të tyre bazë të trajnimit. Mbulohet ndërgjegjësimi kulturor, aftësitë e komunikimit dhe radikalizmi në burgje. Trajnimi zgjat rreth 20 orë dhe zhvillohet përgjatë 2 viteve.
- Trajnim i thelluar për stafin me përvojë (ende në fazën e planifikimit). Kurs mbi radikalizmin dhe ekstremizmin për Shërbimin e Provës, pilotimi i të cilit do të fillojë në pranverën e vitit 2018.

Është hartuar gjithashtu një [manual](#) që synon të pajisë stafin e Shërbimit të Provës me njohuritë bazë mbi fenomenet e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Manuali ndahet në dy pjesë: njohuri mbi fenomenin dhe këshilla për menaxhimin e radikalizmit.

Projekti »Tolerancë« — prezantuar nga Ermin Skoric (instituti Segerstedt)

Projekti »Tolerancë« filloi në vitin 1998. Kjo qasje proaktive për shkollat synon të parandalojë rekrutimin e të rinjve pranë organizatave ekstremiste, dhe të luftojë intolerancën dhe racizmin. Ky projekt përfshin kryesisht nxënësit e moshave 14-15 vjeç, pasi kjo është mosha në të cilën zhvillohet morali i individit. Ai bazohet te një këndvështrim socio-psikologjik dhe te një qasje socio-pedagogjike ndaj të rinjve. Të rinjtë e përzgjedhur nga një grup i përzier (rreth 25 persona), përfaqësojnë background-e të ndryshme sociale, etnike dhe arsimore, dhe vijnë nga shkolla të ndryshme të bashkisë. Ata largohen nga grupi i tyre »i brendshëm« për t'iu bashkuar këtij grupi »të jashtëm« të përzier, në mënyrë që të sfidojnë vetveten. Ky ndërveprim siguron gjithashtu përhapjen e ideve te komuniteti më i gjerë. Në mënyrë që projekti të rezultojë efektiv, është e rëndësishme që të rinjtë të ndihmohen të kuptojnë vetveten dhe botën në të cilën ata jetojnë, si dhe të kuptohen nga të tjerët ashtu siç ata dëshirojnë të kuptohen.

Translated within:

